

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

**DALLIMI NË MES HENDBOLLISTËVE, VOLEJBOLLISTËVE DHE
BASKETBOLLISTËVE KADËT NË DISA KARAKTERISTIKA
MORFOLOGJIKE DHE AFTËSI MOTORIKE**

MENTORI:
Prof. Ass. Afrim Koca

KANDIDATJA:
Lavdije Idrizi-Bytyqi

Prishtinë, maj, 2018

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
1.2 HULUMTIMET E GJERTANISHME	9
2. QËLLIMI I PUNIMIT	17
3. HIPOTEZAT THEMELORE	18
4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	19
4.1 MOSTRA E POPULLATËS	19
4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	19
4.2.1 Ndryshoret morfologjike.....	19
4.2.2 Ndryshoret motorike	20
4.3 TEKNIKA E MATJEVE	21
4.3.1 Teknika e matjeve të ndryshoreve morfologjike	21
4.3.2 Teknika e matjeve të ndryshoreve motorike.....	31
4.4 PËRPUNIMI I REZULTATEVE	38
6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI	
6.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE	39
6.1.1 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike te hendbollistët.....	39
6.1.2 Analiza deskriptive e ndryshoreve motorike te hendbollistët.....	43
6.1.3 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike te volejbollistët.....	46
6.1.4 Analiza deskriptive e ndryshoreve motorike te volejbollistët.....	50
6.1.5 Analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike te basketbollistët	53
6.1.6 Analiza deskriptive e ndryshoreve motorike te basketbollistët	57
6.2 INTERKORELACIONI I NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE	
6.2.1 Interkorelacioni i ndryshoreve antropometrike te hendbolistët, volejbollistet dhe basketbollistët.....	60
6.2.2 Interkorelacioni i ndryshoreve motorike te hendbolistët, volejbollistet dhe basketbollistët	61
6.3 DALLIMET NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE	62
6.3.1 Dallimi në mes hendbollisteve, volejbollisteve dhe basketbollistëve në ndryshoret antropometrike	62
6.3.2 Dallimi në mes hendbollisteve, volejbollisteve dhe basketbollistëve në ndryshoret motorike	65
6.4 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	68
7. PËRFUNDIMI	69
8. LITERATURA	71

1. HYRJE

Sportet ekipore janë aktivitete tepër komplekse, që do të thotë se aktivitetet gjatë lojës mund të realizohen vetëm me veprimin e një sërë karakteristikash motorike dhe antropometrike. Rezultatet të cilat i arrin një basketbollist, hendbollist dhe volejbollist gjatë lojës varet nga faktorë të ndryshëm që ndikojnë në efikasitetin e tij (Trunić & Mladenović, 2014). Të gjithë faktorët nuk mund të ndikojnë në mënyrë të barabartë në rezultat, dhe as që mund të analizohen individualisht pa një lidhje adekuate me faktorë të tjerë. Nga ana tjetër, një faktor nuk ka koeficientin e njëjtë të korrelacionit me faktorë të tjerë, por ndryshon.

Në këto sportet ekipore përgatitja fizike në fazën përgatitore është vendimtare për arritjen e rezultateve të larta sportive. Prandaj, vëmendje e veçantë i kushtohet përzgjedhjes së procedurave metodike dhe ushtrimeve të cilat, në përputhje me mundësitë e teknikës së realizimit, do të mundësojnë lëvizje specifike optimale. Fatkeqësisht, në praktikë, përgatitja fizike shpesh trajtohet ndaras nga përvetësimi i teknikës sportive në sporte. Me këtë, harrohet se kemi të bëjmë me një proces dinamik, në të cilin njëra kushtëzon tjetrën, dhe se vetëm përgatitja fizike e nivelit të lartë mund të siguroj realizim të lartë të teknikës sportive (Hraski et al., 2003).

Hendbolli, volejbolli dhe basketbolli si sporte ekipore kërkojnë një nivel të caktuar të funksionimit të faktorëve antropologjik, në mënyrë që lojtarët me sukses të veprojnë në kushte situacionale. Nga ajo që u përmend më lartë, është e qartë se është e domosdoshme dhe pa ndërprerë kërkimi i vazhdueshëm teorik dhe verifikimi praktik i këtyre specifikave, dhe në sportet sikur që janë, basketbolli, hendbolli dhe volejbolli kjo do të nënkuptonte edhe kontrollimin e disa karakteristikave dhe aftësive antropologjike. Përveç llojllojshmërisë së sporteve, natyrisht ekziston një shumëllojshmëri e strukturave të aftësive dhe karakteristikave antropologjike në mes sportistëve, sepse nëse nuk do të kishim njohuri mbi këto karakteristika dhe aftësi antropologjike, hulumtimi i mjeteve të trajnimit, metodave dhe ngarkesave, si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e aftësive dhe karakteristikave antropologjike, do të ishte e pakuptimtë dhe e panevojshme (Malacko and Rađo, 2004).

Gjithnjë e më shumë sportistë janë të vetëdijshëm për përfitimet e trajnimit të SAQ (speed, agility, quickness). Për shumë vite, trajnerët sportivë kanë lënë pas dore

këtë formë të trajnimit, megjithëse vetëm një qasje e tillë e përgatitjes fizike , nga aspekti i zhvillimit dhe përmirësimit të aftësive të shpejtësisë eksplozive, është lidhja thelbësore midis përgatitjes fizike bazike dhe specifike të sportistëve. Me fjalë të tjera, trajnimi SAQ përfaqëson integrimin e trajnimit bazik dhe trajnimin specifik situacional, i cili zhvillohet në terren. Disa nga përfitimet e trajnimit të shpejtësisë, agjilitetit dhe forcës eksplozive përfshijnë rritjen e forcës muskulore në të gjitha lëvizjet, efikasitetin neuro-muskulor, ndjeshmërinë kinestetike në hapësirë, shpejtësinë e reagimit dhe aftësitë tjera motorike (Brown and Ferrigno, 2005). Zhvillimi i aftësive motorike, përsosja e aftësive motorike dhe motorike specifike gjatë fazës përgatitore, janë komponentë të rëndësishëm që mund të ndikojnë në programimin e ushtrimeve fizike (Bompa, 2005).

Kërkesat teknike-taktike në një numër të madh të disiplinave sportive, sikur që janë sportet, basketbolli, hendbolli, volejboli e tjera, përfshijnë shpesh ushtrime me ndryshime në rrafshin frontal dhe sagjital, lloje të ndryshme të kërcimeve (different types of jumps), midis tyre dhe kërcime të veçanta për një degë të caktuar sportit (Nešić, 2008). Këto karakteristika kërkojnë përgatitje adekuate dhe performancë të lartë në raport me përgatitjen fizike sportive teknike, taktike, bazike dhe specifike motorike, duke pasur parasysh se ekziston numri i madh i teknikave të kërcimeve në varësi të specifikave të sportit (Zatsiorsky and Kraemer, 2006).

Përgatitja e mirë kondicionale, tekniko – taktike do të ndikojë në suksesin e realizimit të testeve situacionale – motorike te sportistët e këtyre sporteve. Për të qenë në gjendje sportisti i këtyre sporteve ti kryej detyrat e caktuara para se gjithash duhet të posedoj nivelin e lartë të aftësive bazike – motorike të cilat fitohen me stërvitje të rregullta të përgatitjes fizike (Verhejn, 1997; Ęeineck, 2000). Për të arritur rezultate të larta në nivel botrorë lojtari përveq përgatitjes fizike duhet të posedoj edhe aftësi teknike, taktike, intelektuale dhe përgatitje psikologjike.

Ndërlidhja e përbashkët e këtyre komponenteve ka për qëllim përgatitjen e gjithanshme si të lojtarit ashtu edhe të ekipit. Përgatitja teknike është bazë fundamentale e procesit stërvitor secilit lojtarë (Bompa 2006). Suksesi në lojën e futbollit sikurse edhe në lojrat tjera vjenë si rezultat i dimensioneve antropometrike. Loja e futbollit bashkohor kërkon përgatitje më të lartë fizike në krahasim me vitet e mëhershme ku qëllim parësor ka qenë përgatitja teknike e lojtarit.

Përgatitja fizike është qelësi elementar për sukses në lojën e këtyre sporteve (Wang, 1995). Në bazë të analizave të shumta të strukturës së lojës së këtyre sporteve mund të konkludojm se pasimi i topit drejt cakut në mënyrë precize paraqet njërin nga faktorët me rëndësi për arritjen e rezultateve të dëshiruara në vplejball dhe hendboll (Joksimović, et al., 2003).

Hendbolli volejboli dhe basketbolli sipas karakteristikave që posedon i përkasin lëvizjeve polistrukturale komplekse, dhe numërohet në kategorinë e sporteve atraktive ekipore. Suksesi në këto sportet varet nga shumë faktorë ndërmjet veti të lidhura siç janë: karakteristikat morfologjike, aftësitë motorike, aftësitë kognitive, veçoritë konative, strukturës motivuese, karakteristikave fiziologjike-funksionale, dinamika e rrethit mikro social, elementeve tekniko-taktike të lojës, si dhe struktura morfologjike e lojtarit. Të gjitha këto gërshetohen në strukturë të përbashkët përgjegjëse për rezultatin sa më të mirë në lojën e hendbollit, volejbollit dhe basketbollit. Antropologjia është hapësirë shumë dimensionale, interaktive dhe se për këtë arsye përcaktimi i përshkrimit të atyre modeleve teorike të nën hapësirës relevante të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në arritjen e sukseseve në lojën e hendbollit ka rëndësi të madhe.

Sportet ekipore kulmore pjesë në grupin e sporteve anaerobe dhe aerobe me kërkesa të mëdha fizike të këtyre kapaciteteve. Aktiviteti i hendbollitit volejbollistëve dhe basketbollistëve bazohet në karakteristikat morfologjike dhe aftësitë e përgjithshme motorike, të cilat i mundësojnë arritjen e njohurive në elementet specifike, situaciono tekniko-taktike, relevante për arritjen e suksesit në lojën e këtyre sporteve ekipore (Bojic me bashk., 2007).

Orientimi dhe përcaktimi i rinisë për sportin e hendbollit, volejbollit dhe basketbollit është i kushtëzuar me dëshirën e vet të riut për këto sporte ekipore ose me anë të selekcionimit nga ana e ekspertëve të këtyre sporteve duke i marr parasysh karakteristikat morfologjike, aftësitë psikomotorike dhe shpejtësinë e të mësuarit si dhe përsosjes së elementeve tekniko-taktike, (Fulgozi, 1994). Selekcionimi, përpos zgjedhjes që duhet bërë, nënkupton edhe orientimin dhe përsosjen e lojtarëve talent dhe potencial kulmor (Paranosic dhe Savic, 1977). Ky është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar i cili kërkon punë ekipore dhe qëndrim multidisiplinar.

Veçorit morfologjike (dimensionet) duhet ti kuptojmë si esencën biologjike dhe fiziologjike e cila gjeneron manifestimin e karakteristikave antropometrike sikur që janë: lartësia e trupit, pesha, perimetri i trupit dhe ekstremiteteve, gjatësitë dhe gjerësitë e kockave, trashësia e indit dhjamor e tjera. Me këto karakteristika definohet rrita dhe zhvillimi i fëmijëve dhe i rinisë, si dhe ndërtimi trupor i tyre (konstitucioni) edhe atë ashtu që me këto vërtetohet struktura e karakteristikave morfologjike.

Aspekti antropometrik është karakteristika më e dukshme e njeriut. Tek të rriturit kjo ka lidhje me sjelljet gjatë jetës, profesionin, sëmundjen, aktivitetin sportiv dhe suksesin. Njohurit dhe studimi i ndërtimit trupor gjatë rritës dhe zhvillimit mundëson që ta kuptojmë më mirë variacionin e konstitucionit të njeriut. Gjatë rritjes së rinisë është i dukshëm ndryshimi kontinuel i lartësisë së trupit e cila karakteristike zgjatë kryesisht deri në moshën 20 vjeçare, edhe pse formimi dhe rritja përfundimtare e kockave përfundon pas moshës 23 vjeçare. Mekanizmi fiziologjik i rritjes dhe formimit të kockave praktikisht është i njëjtë për të gjithë skeletin. Përpos indit kockor edhe indet e buta (muskujt) rriten dhe zhvillohen njëkohësisht. Me dimensione motorike nënkuptojmë ato aftësi të njeriut të cilat marrin pjesë në kryerjen e detyrave motorike dhe kushtëzojnë lëvizje të suksesshme në të gjitha sportet, pa marr parasysh se a janë fituar aftësitë me anë të trajningut apo jo. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapësi vërehet se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme. Shumica e aftësive psikomotorike fitohen dhe zhvillohen kryesisht në periudhën e fëmijërisë. Në këtë periudhë të zhvillimit ndërtohet dhe zhvillohet struktura e hapësirës motorike ndërsa pas periudhës së pubertetit (16 – 18 vjeçare) fillon të stabilizohet (Metikos, 1974, Kurelic me bashk., 1975, Bala, Kis dhe Popovic, 1996). Në këtë fazë të zhvillimit me sukses i përvetësojnë elementet e teknikës sportive duke i ekzekutuar me një intensitet më të lartë, dhe se në këtë periudhë është e nevojshme një proces stërvitor më i avancuar (Duraskovic, 2002).

Loja e hendbollit, volejbollit dhe basketbollit për dallim nga aktivitetet komplekse kineziologjike tjera karakterizohet me përqendrim maksimal, reagim të shpejt, pozita në qëndrimin statik, forcë të madhe eksplozive, dhe me precizitet të lartë. Këto kërkesa të lojës në hendboll, volejmoll dhe basketboll, përpos që kërkojnë nga lojtarët përgatitje të lartë kondicionalë, kërkojnë që këta sportist të kenë karakteristika antropometrike që i

përgjigjen lojës së këtyre sporteve. Këtu përherë mendohet në lartësinë dhe peshën e trupit. Domethënë, karakteristikat morfologjike të hendbollistëve janë ato pjesë të statusit antropologjik që janë më të dukshme dhe që kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha dimensioneve tjetër antropologjike.

Ndërtimi i trupit për këto sporte kulmore nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve të larta në sportet e kategorive të larta. Prapë se prapë, hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjashmëri në ndërtimin dhe në raportin e masës pasive trupore dhe aktive trupore, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dhe duke arritur kategori gjithë e më të larta në e kategorive të larta. Hendbollistët, volejbollistët dhe basketbolistët e përfshirë në hulumtim si sportist të rangut të lartë, shikuar në aspektin morfologjik paraqiten si grup homogjen. Kjo len të kuptojmë se tretmanët kineziologjike gjatë përgatitjes kondicionalë te këto tri lloje të sporteve gjatë fazës përgatitore dhe fazës së garave kanë qenë gati identike.

Njohja e strukturave të disa dimensioneve të statusit psikosomatik të sportistëve të këtyre sporteve (sidomos atij morfologjik dhe motorik), me këte edhe të zhvillimit e tyre, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të drejt me procese stërvitore drejt zhvillimit të gjithanshëm të sportistëve. Duke iu falënderuar hulumtimeve të shumta në të cilat janë angazhuar në vërtetimin e strukturës së disa pjesëve të hapësirës psikosomatike, në shkallën e tashme të zhvillimit të teknologjisë stërvitore, me bindje dhe siguri të plotë mund të flasim mbi ekzistimin e karakteristikave të ndryshme antropometrike si dhe të aftësive motorike.

Përkufizimi i konstitucionit të sportistit është shumë kompleks për shkak të disa faktorëve të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në veçoritë morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të tij. Vet reaktioni i organizmit si tërësi në disa ngacmime respektivisht sjellje në situata të ndryshme të jetes dhe punës përbëjnë grupin e të gjitha veçorive morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të cilët japin karakter konstitucionit të njeriut respektivisht paraqet fenotipin i cili zhvillohet si simbioza e gjenotipit të caktuar i cili është nën ndikimin e faktorëve kompleks të jashtëm. Shumë autorë dukurin apo nocionin e gjenotipit shpesh e kanë identifikuar me konstitucionin trupur. Mirëpo nocioni i konstitucionit është shumë më i gjerë dhe plastik dhe vet mundësia e formimit në kushte të rrethit në të cilën njeriu jeton, nën veprimin e mënyrës

së të jetuarit, punës dhe edukimit na orjenton neve që të kuptojmë se në konstitucionin e njeriut ndikim fundamental kanë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të njeriut.

Hulumtimet në fushën e kineziologjisë përherë janë të orientuara në zbulimin e faktorëve që ndikojnë në arritjen e rezultateve në lojën e hendbollit. Në fushën e morfologjisë dhe konstitucionit trupor të shumë autorë si cak i hulumtimit është përcaktimi dhe ndikimi i tyre në aftësitë motorike dhe motorike-situacionale e që janë parakusht për arritjen e rezultateve sa më të larta në lojën e hendbollit, volejbollit dhe basketbollit.

1.2 HULUMTIMET E GJERTANISHME

Shqyrtimi i hulumtimeve të gjertanishme është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin hulumtimet e gjertanishme në botë dhe një pjesë tjetër përfshin hulumtimet e gjertanishme në Kosovë.

Savic, B., Dragan. D. (2006) në hulumtimin e tyre përshkruan dallimet në karakteristikat antropometrike ndërmjet dy reprezentacioneve të femrave në hendbollit asaj të vitit 1984 dhe 2001 të ish Jugosllavisë. Rezultatet tregojnë për ndryshime në parametrat e volumenit trupor dhe të indit dhjamor në favor të ekipes së vitit 1984. Hendbollistët e reprezentacionit të vitit 2001 në raport me vitin 1984 kanë pasur kërdhokulla më të gjerë, perimetër me te madh të gjoksit, të nën llërës dhe kofshës, dhe më pak ind dhjamor nën lëkuror të ekstremiteteve të epërme.

Në hulumtimin e tyre (Bojic, I. me bashk., 2007) në mostrën prej 200 hendbollistëve të selekcionuar të moshës 12 dhe 13 vjeçare kanë vërtetuar ndryshimet e karakteristikave antropometrike dhe motorike nën ndikimin e proceseve stërvitore gjashtëmujore.

Hulumtimet sa i përket ndikimit të parametrave antropometrik në ekzekutimin e elementeve teknike janë bërë nga autorët (Primoz, P., Marta, B., Marko, S., 2008), që ndër variablat antropometrike të suksesit në lojën e hendbollit ia përshkruajnë lartësisë së trupit.

Në hulumtimin Oxyzoglou, N., Ore, G., Rizos, S. (2009) Departament of Physical Education and Sports Science, Aristotle University of Thessalonica, Serres, Greece, është vërtetuar dallimi në disa karakteristika antropometrike dhe motorike tek hendbollistët Professional të Serbisë dhe Greqisë.

Petroviq (2009) në hulumtimin e tij ku qëllimi i studimit ishte që të hulumtohen efektet e programit të organizuar posaçërisht të edukimit fizik në disa karakteristika morfologjike, motorike dhe psikologjike te nxënësit klasës së shtatë. Studimi ishte i karakterit longitudinal, me përdorimin e metodave eksperimentale. Mësimi i edukimit fizik i organizuar posaçërisht si faktor eksperimentale, i planifikuar dhe i zbatuar për një periudhë prej 24 orëve të mësimit, në periudhën nga 15 shtatori deri më 15 dhjetor të vitit 2009. Mostra kishte përfshirë 58 nxënës të klasës së shtatë, të ndarë në katër

subklasë të veçanta - sipas kriterëve të gjinisë dhe grupit. Të gjithë variablat që janë përdorur në studimin përkasin hapësirës antropologjike: dy variabla antropometrike, tre variablat nga hapësira motorike, variablat nga përvoja emocionale. Konkluzioni i përgjithshëm i rezultateve të fituara dhe ndryshimi i variablave të studiuara të subjekteve të meshkujt dhe femrat, mund të shprehet me këto përfundime: mësimi edukimit fizik, me një program të veçantë të objekteve të organizuara, nuk ka pasur efekt të rëndësishëm statistikor të karakteristikave antropometrike të meshkujt dhe femrat. Ndikim pozitiv kishte në përmirësimin e aftësive motorike, dhe ngritjen e gjendjes emocionale në orët e edukimit fizik, si dhe në rritjen e kohës së ushtrimeve. Mësimi i tillë mund të jetë një bazë e besueshme dhe rekomandimi i edukimit dhe arsimimit fizik bashkëkohor.

Ljubojević, Višnjić dhe Ilić (2012) në hulumtimin e bërë në mostrën prej 140 nxënësve, të ndarë në grupin e kontrollues (31 meshkuj dhe 30 femra) dhe grupin eksperimental (42 meshkuj dhe 37 femra), nxënës të klasëve të shtata. Grupin kontrollues e përbënin nxënësit që kanë vijue rregullisht orët e edukimit fizik, dhe grupin eksperimental e përbënin nxënësit të cilët, përveç orëve të edukimit fizik, kishte edhe dy orë të basketbollit, të cilat ata vetë e kanë zgjedhur. Ndryshimet të testuarit janë përcjellur me anë të shtatë variablave motorike. Studimi ka zgjatur një gjysmëvjetor (gjashtë muaj). Rezultatet treguan se nën ndikimin e programit të basketbollit ka pasur një ndryshim të meshkujt ndërsa në vajzat, nuk kishte asnjë ndryshim në variablat e matura.

Klojcnik (1977) pas përzgjedhjes me anë të metodës klaster ka hulumtuar ndikimin e disa degëve të sportit në zhvillimin e statusit psikosomatike të nxënësve të shkollave fillore. Mostra është përbërë nga 1.455 nxënës, e kanë formuar grupin eksperimental prej 48 grupeve ku janë përfshirë 799 nxënës dhe grupin kontrollues 48 grupe prej 656 nxënësve. Eksperimenti ka zgjatur një vit sipas programit të përcaktuar për çdo lojë sportive, ndërsa grupi kontrollues ka mbajtur orët e rregullta të edukimit fizik. Rezultatet treguan se ka dallime të mëdha në mes të matjes fillestare dhe përfundimtare. Sipas ndikimit në statusin psikosomatik mund të klasifikohen në rendin e mëposhtëm - atletikë, gjimnastikë, basketboll, volejball, not, hendboll dhe futboll.

Firileva (1976, sipas Kocic, 2003) ka hulumtuar karakteristikat antropometrike dhe aftësive motorike të nxënësit pas përzgjedhjes me anë të metodës taksonome e ë cilët ma vonë janë përfshirë në lojën e hendbollit dhe disa sporte tjera. Autori në mostren e përzgjedhur prej rreth 8.000 nxënësve të të dy gjinive të shkollës së Leningradit ka hulumtuar ndikimin e ushtrimeve të rregullta të këtyre sporteve në potencialin motorik dhe se a ekzistin dallim i rëndësishëm në aport me nxënësit të cilët nuk janë të përfshirë në këto sporte. Ka arritur në përfundim se ekzisto një dallim i rëndësishëm në karakteristikat antropometrike dhe aftësitë motorike midis nxënësve të cilët janë të angazhuar dhe ata që nuk janë të përfshirë në lojën e hendbollit.

Balla (1980) ka hulumtuar dimensionet antropometrike dhe motorike te femrat dhe meshkujt pas përzgjedhjes. Në mostrën prej 3102 nxënësve të të dy gjinive, të moshës 6-10 vjeç, nga shkollat fillore të zonave urbane të Krahines Autonome të Vojvodines, në bazë të njëmbëdhjetë testeve motorike, me anë të analizës faktoriale ka vërtetuar se dimensionet antropometrike dhe motorike te meshkujt dhe femrat te të gjitha moshat. Bazuar në rezultatet e analizës faktor të hapësirës motorike, autori arriti në përfundimin se ka të bëjë vetëm një dimension të përgjithshëm – Gjeneral, për shkak se nuk janë të izoluar dimensionet specifike motorike. Kjo tregon se në nivel të sistemit nervor qendror nuk kemi diferencim të qartë të qendrave motorike.

Dimova (1983) në një mostër prej 120 nxënësve të moshës shtatë deri në tetë vite ka hulumtuar rëndësin e përzgjedhjes me anë të metodës taksonome (klaser) dhe pas saj ndikimin e një programi eksperimental një-vjeçare në lojën e hendbollit në cilësitë morfologjike, aftësitë motorike dhe estetike. Rezultatet e hulumtimit treguan se te grupet e trajtuara pas përzgjedhjes me lojën e hendbollit ka pasur ndryshime statistike të rëndësishme në të gjitha dimensionet e testuar në krahasim me grupin e parzgjedhur.

Marusiç (1994) ka vërtetuar se si lëndët zgjedhore (me theks në lojën e hendbollit) mund të ndikojnë, ndër të tjera në zhvillimin e disa dimensioneve morfologjike dhe motorike të nxënësve të shkollave fillore të moshës 11 dhe 12 vjeçare. Mostra është nxjerrë nga popullata me një mostër të përzgjedhur me anë analizës taksonome prej 34 nxënësve të klasës së pestë të shkollës fillore në Nikshiq dhe aftësi biomotorike janë vlerësuar nga një bateri prej 21 testeve. Studimi tregoi se ka pasur një përmirësim në 14 variablat motorike te meshkujt dhe në 12 variabla motorike te femrat.

Rezultatet treguan gjithashtu se tashmë në moshën dymbëdhjetëvjeçare fillojnë të qartësohen dallimet të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të aftësive biomotorike te meshkujt dhe femrat çka autori thekson në përfundim se mësimi i edukimit fizik nga klasa e pestë është e nevojshme të organizohet veç për meshkuj e veç për femra.

Gajiç (1986) ka hulumtuar ndryshimet në zhvillimin morfologjik dhe disa aftësive motorike, koordinimit, të forcës eksplozive dhe fleksibilitetit në periudhën e ontogjenezës prej 11 deri më 14 vjeç. Përcjellja longitudinale është realizuar në mostër prej 200 nxënësve dhe 223 nxënseve në klasën e pestë të shkollës fillore. Matjet janë realizuar 5 herë me ndihmën e 18 testeve motorike për vlerësimin e forcës eksplozive, 13 për vlerësimin e fleksibilitet, 15 për vlerësimin e koordinimit dhe 9 për vlerësimin e vëllimit të lëvizjeve në nyjet. Nga numri i madh i informatave, të cilat i ka mundësuar ky hulumtim, për këtë punë është interesante numri dhe struktura e dimensioneve motorike të fituara. Izolimi i numrit të dimensioneve të rëndësishme nuk ka qenë plotësisht i njëjtë, si dhe struktura e tyre, sipas gjjinisë ashtu edhe sipas pikave matëse. Në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi, autorët konkludojnë se në këtë periudhë te fëmijët paraqiten këta faktorë motorikë. 1).Aftësia për zgjidhjen e shpejtë të detyrave të komplikuar motorike; 2).Koordinimi në ritëm; 3).Koordinimi i këmbëve; 4).Aftësia për amplitudë të lartë të lëvizjes së nyjeve në këllqë; 5).Elasticiteti i kushinetës së këllkut; 6).Elasticiteti i gjithë trupit; 7).Lëvizshmëria e trupit; 8).Elasticiteti i iliopsoasit; 9).Elasticiteti i muskujve të krahërorit; 10).Lëvizshmëria e nyjeve të këllkut; 11).Lëvizshmëria e trupit; 12).Forca eksplozive; 13).Forca eksplozive e ekstremiteteve të larta; 14).Forca eksplozive e karakterit goditës; 15).Aftësia për lëvizjet e shpeshta të karakterit eksploziv, 16, Forca eksplozive e muskujve 17. Strukturimi i levizjeve ekspozive.

Kapidžić, Nožinović dhe Tanović (2006)□ kanë vërtetuar ndikimin e përgaditjes fizike, respektivisht motorike në zhvillimin morfologjik dhe rezultatet e testeve situacionale në lojërën ehendbollit pas përzgjedhjes. Studimi u krye në një mostër prej 80 nxënësve të moshës 12 vjeçare.. Për të përcaktuar ndikimin e gatishmërisë motorike mbi rezultatet e testeve situacionale në hendboll është aplikuar analiza taksonome dhe e regresionit mltipël. Rëndësia teorike e kësaj pune është kryesisht në përcaktimin e

ndikimit parcial të gatishmërisë motorike në rezultatet e testeve situacionale në lojën e hendbolit.

Repija (2012) në hulumtimin e tij ku qëllimi i hulumtimit ishte ndikimi i orëve shtesë të edukimit fizik në zhvillimin motorik të nxënësve të klasëve të ulëta pas përzgjedhjes me anë të analizës taksonome. Numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët e kishin përbër grupin kontrollues dhe grupin eksperimental dhe që ishin nënshtruar testimit motorik ishte 126 tënxënës. Subjektet ishin nxënëset të dy shkollave të ndryshme fillore, ku nxënësit në një shkollë (N = 62) përfaqësoi grupin eksperimental dhe (N = 64) të tjera grupin kontrollues. Instrument matëse për testimin e aftësive motorike përbënin 10 variabla, tre morfologjike dhe 7 motorike. Studimi ishte i karakterit longitudinal dhe kishte zgjatur 12 javë dhe të aq numër të orëve shtesë të trajnimit. Si kriter për rëndësisin statistikore është përdorur niveli i probabilitet 95%, respektivisht, $P < 0,05$. Është konkluduar se nuk ishte fituar dallim i rëndësishëm statistikor i proceseve të transformimit të modeleve eksperimentale, por analiza përshkruese ka konfirmue një përparim të madh në zhvillimin e aftësive motorike te grupi eksperimental.

Petrovic (2009) në hulumtimin e tij ku qëllimi i studimit ishte që të hulumtohen efektet e programit të organizuar posaçërisht të edukimit fizik në disa karakteristika morfologjike, motorike dhe psikologjike te nxënësit klasës së shtatë pas përzgjedhjes me anë të analizës taksonome. Studimi ishte i karakterit longitudinal, me përdorimin e metodave eksperimentale. Mësimi i edukimit fizik i organizuar posaçërisht si faktor eksperimental, i planifikuar dhe i zbatuar për një periudhë prej 24 orëve të mësimin, në periudhën nga 15 shtatori deri më 15 dhjetor të vitit 2009. Mostra kishte përfshirë 58 nxënës të klasës së shtatë, të ndarë në katër subklasë të veçanta - sipas kriterëve të gjinisë dhe grupit. Të gjithë variablat që janë përdorur në studimin përkasin hapësirës antropologjike: dy variabla antropometrike, tre variablat nga hapësira motorike, variablat nga përvoja emocionale. Konkluzioni i përgjithshëm i rezultateve të fituara dhe ndryshimi i variablave të studiuara të subjekteve të meshkujt dhe femrat, mund të shprehet me këto përfundime: mësimi edukimit fizik, me një program të veçantë të objekteve të organizuara, nuk ka pasur efekt të rëndësishëm statistikor te karakteristikat antropometrike të meshkujt dhe femrat. Ndikim pozitiv kishte në përmirësimin e

aftësive motorike, dhe ngritjen e gjendjes emocionale në orët e edukimit fizik, si dhe në rritjen e kohës së ushtrimeve. Mësimi i tillë mund të jetë një bazë e besueshme dhe rekomandimi i edukimit dhe arsimimit fizik bashkëkohor.

Ljubojević, Višnjić dhe Ilić (2012) në hulumtimin e bërë në mostrën prej 140 nxënësve, të ndarë në grupin e kontrollues (31 meshkuj dhe 30 femra) dhe grupin eksperimental (42 meshkuj dhe 37 femra), nxënës të klasëve të shtata ku grupin eksperimental e kanë përbërë nxënësit të përzgjedhur me anë të analizës taksonome. Grupin kontrollues e përbënin nxënësit që kanë vijue rregullisht orët e edukimit fizik, dhe grupin eksperimentale e përbënin nxënësit të cilët, përveç orëve të edukimit fizik, kishte edhe dy orë të basketbollit, të cilat ata vetë e kanë zgjedhur. Ndryshimet të testuarit janë përcjellur me anë të shtatë variablave motorike. Studimi ka zgjatur njëgjysmëvjetor. Rezultatet treguan se nën ndikimin e programit të hendbollit ka pasur një ndryshim të meshkujt ndërsa të vajzat, nuk kishte asnjë ndryshim në variablat e matura

Nikçi (2013) në hulumtimin e tij ka pas për qëllim përcaktimin dhe vërtetimin e analizës taksonome në përzgjedhjen e të rinjëve në sportin e handbollit në bazë të karakteristikave antropometrike të nxënësve të moshës 12 vjeçare. Në mostër janë përfshirë 132 nxënës të shkollave fillore të Komunës së Pejës të ndarë në dy grupe, në të qytetit dhe ata të fshatit. Nxënësit janë testuar gjatë periudhës kohore shkollare shkurt – mars të vitit 2013.

Të gjitha variablat e aplikuara antropometrike, iu janë nënshtruar përpunimeve themelore statistikore, në bazë të së cilës është vërtetuar se të gjitha testet kanë karakteristika metrike të kënaqshme. Përcaktimi dhe ndarja e grupeve për interesat e këtij punimi është aplikuar analiza taksonome e cila në bazë të karakteristikave antropometrike ka bërë grupimin e nxënësve dhe ka ndarë nxënësit të cilët mund të përzgjedhen për sportin e hendbollit. Ndryshimi në mes mesatareve aritmetikore të rezultateve të grupeve të hulumtuara është përcaktuar me anë të analizës diskriminative univariante T-testit. Analiza taksonome, rezultatet e fituara nga matjet antropometrike tek nxënësit nga qyteti dhe fshati i ka grupue në dy grupe, grupin e parë dhe të dytë. Kjo analizë ka përbush kërkesat të cilat janë parashtruar me qëllim të ndarjes së nxënësëve sipas zhvillimit morfologjik e që është një ndër karakteristikat themelore në suksesin e lojës së hendbollit.

Argumentet e fituara tregojnë se pasqyra më reale sa i perket përzgjedhjes e të rinjëve për sportin e hendbollit në bazë të parametrave antropometrik analiza taksonome është ndër analizat më të mira.

Punimet e autorëve nga Kosova janë të paraqitura me sa vijon:

Zeqa (2004) ka bërë hulumtim me qëllim që të konstatohen disa karakteristika antropometrike dhe motorike me testet motorike-situacionale te hendbollistët e ligës së parë të Kosovës në hapësirën manifeste dhe latente.

Koca (2009) Në hulumtimin e tij me temën: "Relacionet dhe ndryshimet në hapësirën antropometrike, funksionale dhe aftësive lëvizore bazike dhe lëvizjeve situacionale ndërmjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të kosovës në hendboll" janë vërtetuar relacionet në hapësirën manifeste dhe janë identifikuar faktorët latent duke e aplikuar analizën faktoriale dhe dallimet dhe anë të T-testit.

Mullabaz (2011) me qëllim të vërtetimit të objektivit primar të punimit i cili është mbështetur në vlerësimin e rritës dhe zhvillimit të popullatës rinore shkollore të ciklit të lartë edhe atë në zhvillimit biologjik gjatë periudhave të caktuara kohore dhe ndikimit të disa aftësive motorikë bazike dhe atyre motoriko-situacionale të nxënësve ka përfshirë mostrën e të testuarve prej 240 nxënësve të dy gjinive. Rezultatet e fituara tregojnë se gjatësia e shuplakës së dorës dhe gjerësia e saj nuk janë në korelacion me testet situaciono-motorike të lojës së voleybollit. Kjo nuk do të thotë se nadhësia e shuplakës së dorës nuk ka ndikim në suksesin e lojës në hendboll. Këtë korelacion të pëndësishëm të ndryshoreve antropometrike me testet situacionale duhet kërkuar në ndryshimet në zhvillimin morfologjik të rinisë si dhe në objektivitetin e matjeve. Dallimet në mes të nxënësve të dy gjinitë në zhvillimin morfologjik, motorik dhe motoriko-situacional tregojnë për ndryshime individuale të individve gjatë fazes së rritjes e që i përkasin faktorit gjenetik.

Hetemi (2014) në punimin "Dallimi në mes nxënësve dhe nxënësve të angazhuar në seksionin e hendbollit në disa parametra antropometrik dhe motorik bazike" SI Qëllimi parësor kishte që të përcaktohet dhe vërtetohet dallimi në mes nxënësve që i u janë nënshtruar seancave stërvitore si orë shtesë në kuadër të seksionit shkollor të hendbollit në ndryshoret antropometrike dhe motorike bazike. Në këtë punim (hulumtim) janë

përfshirë 30 nxënës të klasave të dhjeta të moshës 16 vjeçare që kanë pasur vetëm orë të rregullta të edukatës fizike dhe 30 nxënës të klasave të dhjeta të moshës 16 vjeçare që janë nënshtruar seancave stërvitore si orë shtesë në kuadër të sekseionit shkollor të hendbollit krahas orëve të rregullta pranë shkollës së mesme teknike SHMT "Anton Qeta" nga Skenderaj. Përpunimi i rezultateve tregon se grupet e nxënësve sa i përket parametrave antropometrik dallohen në gjatësinë e krahut dhe indin dhjamor nën lëkuror ku nxënësit e përfshirë në seancat stërvitore dy here në javë kanë pasur gjatësi të dorës më të madhe dhe vlera të indit dhjamor nën lëkuror më të ulëta. Sa i përket aftësive motorike nxënësit e përfshirë në seancat stërvitore dy here në javë kanë pasur rezultate më të mira në ndryshoret, vrapim në 30 m nga starti i lartë, tappingu me këmbë, tetëshe me përkulje, dhe në gjitha ndryshoret e karakterit të forcës eksplozive (testet me medicinball).

Koci (2014) hulumtimin e ka zbatuar me qëllim të përcaktimit dhe vërtetimit të ndikimit të ndryshoreve antropometrike në realizimin e disa detyrave motorike specifike. Me qëllim të realizimit të këtij hulumtimi në këtë punim (hulumtim) janë përfshirë 30 nxënës të klasave të dhjeta të moshës 16 vjeçare. Nxënësit e përfshirë në hulumtim kanë qenë të gjinisë mashkullore dhe kanë qenë nxënës të shkollës së mesme teknike SHMT "Anton Qeta" nga Skenderaj. Në hulumtim janë aplikuar 9 ndryshore antropometrike: Lartësia e trupit, Gjatësia e krahut, Gjatësia e shuplakës, Gjerësia e shuplakës, Gjatësia e këmbës, Gjatësia e shputës, Peshja e trupit, Perimetri i krahut, Indi dhjamor nën lëkuror i barku dhe dy ndryshoret të precizitetit situacional, Gjuajtja nga vendi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra dhe Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra. Për realizimin e qëllimit të hulumtimit është aplikuar analiza regresive. Rezultatet e fituara nga analiza regresive tregojnë se në ndryshoren ose Gjuajtjen nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra (GJK10P9M), ndikim të rëndësishëm statistikor nuk ka asnjë ndryshore antropometrike, pra gjithë koeficientët nga kolona (Beta) nuk janë të rëndësishëm $p > 0.05$. Kjo tregon se gjatë matjeve duhet me pas kujdes më të madhe dhe se saktësia e matjeve duhet me qenë në nivel, sepse gjatë përpunimit dhe interpretimit haset në vështërsi.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Lojërat polistrutturale komplekse sikur që janë hendbolli, volejboli dhe basketbolli për dallim nga aktivitetet monostrutturale kineziologjike tjera karakterizohet me përqendrim maksimal, reagim të shpejt, pozita në qëndrimin statik, forcë të madhe eksplozive, dhe me precizitet të lartë. Këto kërkesa gjatë lojës në këto sporte, përpos që kërkojnë nga lojtarët përgatitje të lartë kondicional, kërkojnë nga lojtarët të kenë karakteristika dhe aftësi antropologjike që i përgjigjen lojëspërkatëse. Nga ky kontekst del edhe qëllimi i këtij punimi.

Qëllimi i punimit është që të vërtetohet ndikimi i stërvitjeve specifike në disa karakteristika morfologjike dhe motorike te sportistët e sporteve ekipore, konkretisht, hendbooll, volejboll dhe basketboll.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Duke u mbështetur në qëllimin e këtij punimi janë parashtruar këto hipoteza :

H1. Lojtarët e lojës së hendbollit do të paraqiten si grup më homogjen në karakteristikat morfologjike dhe motorike krahasuar me lojtarët e lojës së volejbollit dhe basketbollit.

H2. Në mes lojtarëve të lojës së hendbollit, volejbollit dhe basketbollit ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në karakteristikat morfologjike.

H3. Në mes lojtarëve të lojës së hendbollit, volejbollit dhe basketbollit ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në aftësitë motorike.

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

4.1 MOSTRA E POPULLATËS

Popullata nga e cila do të nxjerret mostra për hulumtim për këtë punim është definuar si popullatë e sportistëve kadet në lojën e hendbollit, volejbollit dhe basketbollit në superligën e Kosovës. Mostra për qëllimet e këtij hulumti do të përfshij 90 sportist, respektivisht, 30 hendbollist, 30 volejbollist dhe 30 basketbollist. Matjet e ndryshoreve antropometrike dhe testeve motorike janë kryher në sallat sportive të klubeve përkatëse gjatë periudhës tetor dhe nëntor të vitit 2017.

4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE

4.2.1 Ndryshoret morfologjike

Janë apikuar këto ndryshore morfologjike:

Nr.	Shkurtesa	Kuptimi
1	ALARTË	Lartësia e trupit
2	AGJEKR	Gjerësia e krahëve
3	AGJASH	Gjatësia e shuplakës
4	AGJESH	Gjerësia e shuplakës
5	AGJKËM	Gjatësia e këmbës
6	AGJSHP	Gjatësia e shputës
7	APESHA	Pesha e trupit
8	APERGJ	Perimetri i gjoksit
9	APERKR	Perimetri i krahut
10	APERKO	Perimetri i kofshës

4.2.2 Ndryshoret motorike

Për vlerësimin e aftësive motorike janë aplikuar këto ndryshore:

Nr.	Shkurtesa	Kuptimi
1	MVR20L	Vrapim 20 metra nga starti i lartë
2	MKGJVE	Kërcim së gjati nga vendi
3	MKLAVE	Kërcim së larti nga vendi
4	MTTEST	T-testi i agjilitetit
5	MTILIO	Testi Ilionis
6	MHTMKO	Hedhja e topit medicinal mbi kokë.
7	MHTMGJ	Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit.

4.3 TEKNIKA E MATJEVE

4.3.1 Teknika e matjeve të ndryshoreve morfologjike

1. Lartësia e trupit (ALARTË)

Ndryshoret antropometrike janë matur sipas mënyrës si vijon:

Mjetet: Antropometri sipas Martinit

Lartësia e trupit është matë me antropometër, sportisti që është matë ka qenë i zbathur, në veshje sportive dhe ka qëndruar në bazamentin e fortë horizontal të antropometrit. Koka e tij ka qenë në atë pozitë që skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale (horizontalja e Frankfurtit).

Qëndrimi i trupit të entitetit ka qenë në i relaksuar dhe i drejtë, shputat e bashkuara, ndërkaq matësi ka qëndruar në të majtë të entitetit.

Pasi që e kontrollon pozitën e entitetit dhe të instrumentit (antropometri), matësi e lëshon krahun horizontal të antropometrit deri në pjesën e eperme të kokës (pika më e lartë e kokës – vertex) dhe e lexon në shtyllën e antropometrit pikën e lartësisë.

Foto 1. Matja e lartësisë së trupit



2. Gjerësia e krahëve (AGJEKR)

Gjerësia e krahëve, është matur me antropometer. I testuari qendron me duar te haupra horizontalisht ne nivel te kraheve, dhe me shuplaka te kthyer nga poshtë . Matja kryhet nga daktilioni i dores se djatht deri tek daktilioni i dores se majt, rrezulltati lexohet me sakte si 0.1 cm.

Foto 2. Matja e gjerësisë së krahëve



3. Gjatësia e shuplakës (AGJASH)

Gjatësia e shuplakës është matur me antropometër të shkurtuar milimetrik dhe është matë prej gjatësisë së nyjës së dorës deri te skaji i poshtëm i gishtit të mesëm (i gjatë). Rezultati në fletëtestim është shënuar me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 3. Matja e gjatësisë së shuplakës



4. Gjerësia e shuplakës (AGJESH)

Gjerësia e shuplakës është matë me antropometër të shkurtuar milimetrik. I testuari hap gishtat e shuplakës ashtu që gishtrinjët e shuplakës së të testuarit të kenë distancë sa më të madhe. Gjerësia e shuplakës së dorës matet prej gishtit të vogël deri të gishti i madh (tërthorazi). Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 4. Matja e gjerësisë së shuplakës



5. Gjatësia e këmbës (AGJKËM)

Gjatësia e këmbës është matet me antropometër sipas martinit.

I testuari i zbathur dhe me brekë të lëshuara, ka qëndruar në drejtëqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Maja e akrepit të antropometrit vendoset në anën e majtë të përparmë të kokërdhokut (spina iliaca anterior superior) dhe lexohet lartësia e sajë nga baza horizontale e antropometrit. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 5. Matja e gjatësisë së këmbës



6. Gjatësia e shputës (AGJSHP)

Gjatësia e shputës është matë me kompas rrëshqitës, i testuari qëndron ulur me këmbën e majtë të mledhur që formon këndin e drejtë dhe me shputë të vendosur në dysheme.

Matësi i vendos krahët e kompasit rrëshqitës në thembër dhe në gishtin më të gjatë të shputës. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 6. Matja e gjatësisë së shputës



7. Pesha e trupit (APESHA)

Pesha e trupit është me peshorën antropometrike, e cila mundëson saktësinë e matjës prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vihet në pozitë horizontale dhe në bazament të fortë. I testuari është i zbathur në brekë të shkurtëra, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshorës. Pasi të qetësohet boshti (treguesi) i peshorës në pozitën ekuilibruese lexohet rezultati. Leximi i rezultatit bëhet me saktësi 0.1 kg.

Foto 7. Matja e peshës së trupit



8. Perimetri i gjoksit (APERGJ)

Perimetri i gjoksit është matë me shirit metrik në të cilin janë të shënuara milimetrat dhe centimetrat. I testuari qëndron në këmbë. Shiriti vendoset në rrafshin horizontal në nivel të artikulationit të katërt kosto-sternal, duke kaluar mbi ulësen e poshtme të shpatullave dhe në përfundim të muskujve pectoralis major. Perimetri matet në fund të nje frymënxjerrje normale. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 8. Matja e perimetrit të gjoksit



9. Perimetri i krahut (APERKR)

Perimetri i krahut (në fleksion dhe i kontrahuar) është matë me traken matëse gjysmë plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me dorën e majt të lakuar më brryl dhe të shtrënguar. Traka matëse mbështjellët rreth krahut të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 9. Matja e perimetrit të krahut



10. Perimetri i kofshës (APERKO)

Mjetet: shiriti centimetrik

Perimetri i kofshës matët me shiritin centimetrik. I maturi qëndron drejt me këmbë diç të larguara njëra nga tjetra, me peshë të shpërndarë në dy këmbët.

Shiriti centimetrik mbështillet horizontalisht rreth këmbës së majtë, nën lugun gluteal vendin më të gjërë të kofshës. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 10. Matja e perimetrit të kofshës



4.3.2 Teknika e matjeve të ndryshoreve motorike

Ndryshoret motorike janë vlerësuar sipas mënyrës si vijon:

1. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MVR20L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 20m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarës: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. E testuara udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 11. Vrapim 20 metra nga starti i lartë



12. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Pozita fillestare: I testuari qëndron i kthyer me fytyrë nga drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

Realizimi i detyrës: I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Foto 12. Kërcim së gjati nga vendi



3. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjërësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë, i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi

(tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë , i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet ju ipen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. I testuari bënë disa tentime provuese.

Foto 13. Kërcim së larti nga vendi



4. T-testi i agjilitetit – MTTEST

Instrumentet: Fusha 10m x 10m e ndarë në dy pjesë. 5 tapa per ndarjen e fushës.


Pozita fillestare: I testuari vendoset para vijes startuese në mes dy tapave dhe pret shenjën për startim

Realizimi i detyrës: I testuari vrapon nga vija startuese te tapa 1 dhe prek tapen 1 me doren e majtë, kthehet anash të djathtë te tapa 2 dhe prek tapem me doren e djathtë dhe kthehet anash te tapa 3, prektapen 3 me dorën e majtë dhe kthehet me vrap anash te tapa 1 dhe prek me doren e djathtë dhe kthehet me vrap prapa te vija startuese. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sek.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë nga dy perpjekjet.

